

VENDIM
Nr. 13, datë 7.3.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari	kryesuese;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 7.3.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (V) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Viktor Ymeraj, përfaqësuar nga avokat Ardian Visha, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-739(45), datë 8.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Aplikimi i nenit 51 të Kodit Penal për përgjysmimin e dënimit të caktuar me vendimin nr. 319, datë 25.10.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 29, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Viktor Ymeraj është proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për veprat penale “Vrasjes me paramendim” e mbetur në tentativë, “Vrasje me dashje” dhe “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 78 e 22, 76 dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (*KP*), për ngjarjen e ndodhur më datë 24.7.2000 në fshatin Fratar, Mallakastër. Në këtë ngjarje, me një armë zjarri pistoletë që mbante pa leje të organeve kompetente, kërkuari ka qëlluar në drejtim të shtetasit M.S., i cili ka qenë i ulur në tavolinë në mjediset e një lokali bashkë me dy persona të tjerë. Si rezultat i të shtënave me armë kanë mbetur të plagosur shtetasit M.S. dhe K.K., ndërsa ky i fundit ka ndërruar jetë më pas në spital. Ndaj kërkuarit është caktuar masa e sigurimit personal “Arresti në burg”, e cila nuk është zbatuar asnjëherë për shkak se ai

i ishte fshehur drejtësisë. Kërkuesi është akuzuar për veprat penale të sipërpërmendura dhe çështja është dërguar për gjyq.

2. Procesi gjyqësor është zhvilluar në mungesë të kërkuesit, i cili është përfaqësuar nga një mbrojtës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 319, datë 25.10.2001 (*vendimi nr. 319/2001*), ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprat penale “Vrasja me paramendim” e mbetur në tentativë në dëm të shtetasit M.S. dhe në mbështetje të neneve 78 e 22 të KP-së dënimin e tij me 17 vjet burgim, “Vrasja me dashje” indirekte në dëm të shtetasit K.K dhe në mbështetje të nenit 76 të KP-së dënimin e tij me 20 vjet burgim, si dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe në mbështetje të nenit 278, paragrafi i dytë, të KP-së dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të KP-së, gjykata ka caktuar ndaj kërkuesit një dënim të vetëm prej 25 vjetësh burgim, i cili fillonte nga dita e ekzekutimit të vendimit. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 20.12.2001, pasi ndaj tij nuk është bërë ankim.

3. Vendimi i dënimit penal ka mbetur pa u ekzekutuar deri kur kërkuesi është arrestuar në Greqi dhe është ekstraduar në Shqipëri më datë 25.4.2016, ditë kur është përpiluar dhe procesverbali i ekzekutimit të vendimit nr. 319/2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Pasi vendimi i dënimit penal me burgim është vënë në ekzekutim, kërkuesi i është drejtuar gjykatës së zakonshme paralelisht me disa kërkesa, thelbi i të cilave lidhej me masën e dënimit të caktuar me këtë vendim, pikërisht më zbatimin e nenit 51 të KP-së, për sa kohë që kërkuesi ka pretenduar se në kohën e kryerjes së veprave penale ai nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç, për rrjedhojë dënimin me burgim i dhënë ndaj tij duhej të ishte i përgjysmuar.

Procesi i parë

4. Më datë 4.5.2016 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë për shuarjen e dënimit penal me burgim të caktuar me vendimin nr. 319/2001 të po asaj gjykate për shkakun e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit. Sipas tij, referuar nenit 51 të KP-së së kohës, dënimi që mund të caktohej për të, në çdo rast nuk mund të ishte më shumë se 12 vjet e 6 muaj burgim. Sipas kërkuesit, për sa kohë që nga dita kur vendimi i dënimit kishte marrë formë të prerë (data 20.12.2001) kishin kaluar më shumë se 10 vjet, bazuar në nenin 68, shkronja “b”, të KP-së, ekzekutimi i dënimit ndaj tij ishte parashkruar.

5. Me vendimin nr. 62-2017-4603 (1613), datë 5.10.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në prova dhe ligj. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 373, datë 29.5.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Mbi bazën e rekursit të kërkuesit çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 31.10.2018 dhe sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të kësaj gjykate statusi i saj vijon të jetë “*Në proces*”.

Procesi i dytë

6. Më datë 16.5.2016, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë nr. 319/2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, prishjen e tij dhe rigjykimin e çështjes. Sipas kërkuesit, vendimi penal duhej të rishikohej bazuar në nenin 449, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), në nenin 51, pika 4, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale” dhe në vendimin nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), pasi gjykimi i çështjes penale ishte zhvilluar në mungesë të tij dhe ai ishte ekstraduar nga jashtë shtetit për ekzekutimin e atij vendimi.

7. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 5, datë 18.1.2018, ka shpallur moskompetencën e saj lëndore, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bazuar në parashikimet e reja ligjore të KPP-së, të miratuara me ligjin nr. 35/2017, që përcaktojnë gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 427, datë 8.3.2018, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata

e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 339, datë 5.6.2018, ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke e kthyer çështjen për rigjykim. Në rigjykim, me vendimin nr. 21, datë 14.1.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur përsëri mospranimin e kërkesës për rishikim, vendim i cili në vijim është lënë në fuqi me vendimin nr. 224, datë 11.4.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kërkuesi nuk ka paraqitur rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit. Sipas kërkuesit, pas përfundimit të procesit gjyqësor me objekt korrigjimin e gabimit material në vendimin penal nr. 319/2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (*procesi i tretë*), ai ka humbur interesin për vazhdimin e procesit të rishikimit të këtij vendimi, për sa kohë që e drejta e tij ishte realizuar me vendimin e formës së prerë nr. 138, datë 20.7.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Procesi i tretë

9. Më datë 26.5.2016, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë për korrigjimin e gabimit material në vendimin penal të formës së prerë nr. 319/2001 të po asaj gjykate, me pretendimin se dënimi i dhënë për të prej 25 vjetësh burgim nuk ishte përgjysmuar konform detyrimit të përcaktuar në nenin 51 të KP-së.

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 2144, datë 28.12.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në prova dhe ligj, me arsyetimin se pretendimi i kërkuesit nuk është i drejtë dhe se baza ligjore e kërkesës nuk është e saktë, pasi pretendimi bazohet në nenin 114 të KPP-së, i cili nënkupton ndreqjen e gabimeve materiale në urdhrat dhe vendimet e gjykatës, ndërkohë që mosaplikimi i nenit 51 të KP-së në rastin konkret nuk është gabim material në kuptim të këtij neni, por i përket zgjidhjes në themel të çështjes. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

11. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 138, datë 20.7.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe, duke e gjykuar çështjen në fakt, ka vendosur ndreqjen e gabimit në vendimin penal nr. 319/2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në këtë mënyrë: *“Aplikimin e nenit 51 të Kodit Penal duke përgjysmuar dënimin e caktuar ndaj të pandehurit Viktor Ymeraj prej 25 (njëzet e pesë) vjet burgim, sipas këtij vendimi.”*. Sipas gjykatës së apelit, vendimi nr. 319/2001 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në pjesën arsyetuese dhe vendimmarrëse të tij ka një gabim material të dukshëm që lidhet me mosaplikimin e nenit 51 të KP-së, ndërsa rezulton se kërkuesi ka qenë nën moshën 18 vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale, ndaj dënimi i tij nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënitimit të parashikuar nga ligji për atë vepër penale. Sipas asaj gjykate, aplikimi i nenit 51 të KP-së nuk është i drejtë ose prerogativë e gjykatës që gjykon çështjen, por një detyrim i përcaktuar me ligj dhe i detyrueshëm për t’u zbatuar nga gjykata. Aplikimi i një dënimi që nuk parashikohet nga ligji përbën gabim material nga ana e gjykatës që ka shqyrtuar çështjen dhe, si i tillë, duhet të ndreqet, pasi çdo disponim i kundërt do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të kërkuesit, duke u urdhëruar nga gjykata një dënim në kundërshtim me dispozitat materiale penale dhe mënyrën e caktimit të dënitimit. Gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas së cilës kompetente për shqyrtimin e pretendimit të kërkuesit është Gjykata e Lartë, pranë së cilës ai kishte paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë, për sa kohë ajo lidhej me të drejtën e të dënuarit që ekstradohej dhe nuk kishte të bënte me themelin e çështjes penale në ngarkim të tij, për më tepër kur Gjykata e Lartë ende nuk kishte disponuar për pranimin e saj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

12. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pas shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, me vendimin nr. 00-2023-739(45), datë 8.2.2023, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas Kolegjit Penal, vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material procedural, për sa kohë që e ka konsideruar “gabim material”, sipas nenit 114 të KPP-së, ometimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në vendimin objekt kërkesë për korrigjim, për të aplikuar në favor të të pandehurit të mitur nenin 51 të KP-së. Kolegji Penal ka theksuar se procedura e korrigjimit të

gabimit material lejohet ekskluzivisht në rastet kur bëhet fjalë për të eliminuar mospërputhjen midis shqiptimit formal të një vendimmarrjeje dhe përmbajtjes në thelb të saj, duke vlerësuar se qëndrimi i gjykatës së apelit për të kualifikuar në cilësinë e gabimit material ometimin e gjykatës së themelit në caktimin e dënimit ndaj kërkuesit, përbën një ndërhyrje në drejtëm të modifikimit thelbësor të disponimit të vendimit të gjykatës që ka caktuar dënimin dhe, në këto kushte, si të papajtueshëm me thelbin e parimit të procedurës së korrigjimit të gabimit material.

13. Nga ana tjetër, Kolegji Penal ka vërejtur se referuar pretendimit konkret të kërkuesit, i kualifikuar si gabim material nga gjykata e apelit nën justifikimin e paligjshmërisë së dënimit të caktuar ndaj tij, pa paragjykuar këtë konkluzion të saj, duke evidentuar pa asnjë ekuivok se caktimi i këtij dënimi në këto kushte përbën një dënim të paligjshëm, në të njëjtën kohë konsideron se paligjshmërisë së këtij dënimi nuk mund t'i jepet zgjidhje, në kuptimin e korrigjimit të saj, me procedurën e ndreqjes së gabimit material, por vetëm nëpërmjet goditjes së vendimit të dënimit në rrugën normale të ankimit në të gjitha shkallët e gjyqësorit, pa përjashtuar edhe rrugën e paraqitjes së ankimit të jashtëzakonshëm në formën e rishikimit të vendimit (në eventualitetin e formës së prerë të tij).

Procesi i katërt

14. Më datë 12.6.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është regjistruar kërkesa e kërkuesit me objekt rishikimin e vendimit penal të formës së prerë nr. 319/2001 të asaj gjykate dhe aplikimin e nenit 51 të KP-së, duke përgjysmuar dënimin e caktuar ndaj tij me këtë vendim. Sipas kërkuesit, vendimi penal në fjalë duhej të rishikohej bazuar në nenin 450, shkronja “c”, të KPP-së, me pretendimin se dënimi me burgim i caktuar ndaj tij kapërcen maksimumin e parashikuar nga ligji penal i kohës për këtë lloj dënimi për të miturin, ndërkohë që pas këtij vendimi ka dalë një provë e re që tregon se vendimi është i gabuar, duke iu referuar për këtë vendimit nr. 00-2023-739(45), datë 8.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në procesin e tretë.

15. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. (62-2023-2586)781, datë 26.6.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor nga marrja dijeni për vendimin objekt kërkesë për rishikim dhe se nuk ekzistonte asnjë prej shkaqeve të rishikimit. Këtij vendimi i është dhënë forma e prerë nga sekretaria gjyqësore e asaj gjykate mbi shkaku se nuk është paraqitur ankim brenda afatit ligjor.

16. Ndërkohë, më datë 4.10.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është regjistruar kërkesa e kërkuesit nëpërmjet së cilës ka kërkuar deklarin e pavlefshmërisë absolute të aktit të njoftimit të vendimit penal nr. 62-2023-2586(781), datë 26.6.2023 të kësaj gjykate, urdhërimin e sekretarisë për të kryer korrigjimet e nevojshme dhe regjistrimin e ankimit ose, në alternativë, rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër këtij vendimi. Kjo kërkesë është pranuar nga ajo gjykatë me vendimin e datës 8.2.2024.

17. Në këto kushte, procesi gjyqësor në lidhje me kërkesën për rishikimin e vendimit është në vijim, ndërsa çështja tashmë, mbi ankimin e kërkuesit, do t'i nënshtrohet shqyrtimit nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Procesi kushtetues

18. Më datë 12.6.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-739(45), datë 8.2.2023 të Gjykatës së Lartë, i dhënë në përfundim të *procesit të tretë gjyqësor*, me objekt korrigjimin e gabimit material në vendimin penal të formës së prerë nr. 319/2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

19. Kolegji i Gjykatës, më datë 29.9.2023 ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 5.10.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

20. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

20.1. *Parimit të mosdënimit pa ligj*, të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës dhe neni 7 i KEDNJ-së, pasi në kohën e kryerjes së veprës penale kërkuesi ka qenë i mitur. Dënimi i caktuar për të ka marrë formë të prerë në gjykatën e shkallës së parë, e cila e ka dënuar me 25 vjet burgim, çka përbën maksimumin e ndëshkimit për ligjin e kohës. Gjykata ka pasur detyrimin për të aplikuar nenin 51 të KP-së, i cili parashikon se për të miturit, të cilët në momentin e kryerjes së veprës penale janë nën 18 vjeç, dënimi nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit. Në aplikim të kësaj dispozite penale, dënimi për kërkuesin nuk mund të kalonte 12 vjet e 6 muaj burgim. Kjo dispozitë është ometuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, duke i caktuar një dënim më të rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin e kryerjes së veprës penale. Mosaplikimi i nenit 51 të KP-së duhej të ishte korrigjuar nga Gjykata e Lartë, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit si mjeti i fundit në dispozicion për kërkuesin.

20.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18, pika 1, i Kushtetutës, pasi dënimi i caktuar pa ligj i ka mohuar kërkuesit përfitimin e të drejtave njësoj si të dënuarit e tjerë të mitur, si dhe të drejtën e shuarjes së dënimit për shkak të parashkrimit, pasi vendimi i dënimit është vënë në ekzekutim më datë 25.4.2016, në tejkallim të afatit 10-vjeçar që parashikon neni 68, shkronja “b”, i KP-së për parashkrimin e dënimeve deri në 15 vjet burgim. Megjithatë, referuar dënimit prej 25 vjetësh burgim, kjo kërkesë e kërkuesit është rrëzuar nga të dyja shkallët e gjyqësorit, ndërsa ai vijon të vuajë prej 7 vjetësh një dënim, ekzekutimi i të cilit është parashkruar. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka zgjatur pasojat e paligjshmërisë dhe ka mohuar të drejtat e kërkuesit.

21. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

21.1 Kërkuesi nuk legjitimohet, pasi nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike në dispozicion. Vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk është përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, pasi jo vetëm që nuk vendos në mënyrë përfundimtare për thelbin e së drejtës së kërkuesit, që ka të bëjë me fajësinë ose pafajësinë për veprën penale për të cilën ai akuzohet, por nuk provohet se nëpërmjet kësaj procedure gjykata ka cenuar të drejtat themelore të kërkuesit, të cilat mbrohen gjatë një gjykimi të mirëfilltë. Në këto rrethana, kërkuesi duhet të shterojë mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e interesave të tij gjatë procesit të rishikimit të vendimit të themelit të çështjes, ku mund të ngrejë pretendime në lidhje me cilësimin juridik të fakteve, ose cenimin e të drejtave kushtetuese nga vendimi, si dhe të paraqesë prova në mbështetje të pretendimeve të tij, përfshirë edhe mbrojtjen në këtë gjykatë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

22. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

23. Gjykata vlerëson se kërkuksi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit është dhënë vendimi i kundërshtuar, duke provuar interesin e tij në çështjen e parashtruar.

24. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Ky kriter kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuksi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 38, datë 2.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkuksi nuk legjitimohet, pasi nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike në dispozicion. Sipas tij, vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk është përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pasi nuk vendos në mënyrë përfundimtare për thelbin e së drejtës së kërkuksit, që ka të bëjë me fajësinë ose pafajësinë për veprën penale për të cilën ai akuzohet, sikundër as nuk provohet se nëpërmjet kësaj procedure gjykata ka cenuar të drejtat themelore të tij, të cilat mbrohen gjatë një gjykimi të mirëfilltë. Kërkuksi duhet të shterojë mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e interesave të tij gjatë procesit të rishikimit të vendimit të themelit të çështjes, ku mund të ngrejë pretendime në lidhje me cilësimin juridik të fakteve ose cenimin e të drejtave kushtetuese nga vendimi, si dhe të paraqesë prova në mbështetje të pretendimeve të tij, përfshirë edhe mbrojtjen në këtë gjykatë.

26. Gjykata vëren se kërkuksi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë të dhënë në përfundim të procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga kërkuksi, në kuptim të nenit 114 të KPP-së, për korrigjimin e gabimit material në vendimin penal të formës së prerë nr. 319/2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuksit ajo do ta trajtojë prapësimin e subjektit të interesuar së bashku me themelin e pretendimeve.

27. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mban datën 8.2.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë më datë 12.6.2023. Rezulton se kërkuksi është njoftuar për vendimin e kundërshtuar më datë 11.5.2023, në adresën elektronike të përfaqësuesit

të tij, ndaj është kjo datë momenti nga i cili fillon afati ligjor 4-mujor i përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

29. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj dhe parimit të barazisë përpara ligjit, të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues. Megjithatë, duke marrë në konsideratë thelbin e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, Gjykata çmon t'i analizojë pretendimet e kërkuesit, në vijim, në këndvështrim të parimit të mosdënimit pa ligj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj

30. Sipas kërkuesit, në kohën e kryerjes së veprës penale ai ka qenë i mitur ndaj gjykata ka pasur detyrimin për të aplikuar nenin 51 të KP-së, i cili parashikon se për të miturit, të cilët në momentin e kryerjes së veprës penale janë nën 18 vjeç, dënimi nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit, ndaj, në aplikim të kësaj dispozite penale, dënimi për të nuk mund të kalonte 12 vjet e 6 muaj burgim. Kjo dispozitë, sipas kërkuesit, është ometuar në zbatim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, duke i caktuar një dënim më të rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin e kryerjes së veprës penale. Mosaplikimi i nenit 51 të KP-së duhej të ishte korrigjuar nga Gjykata e Lartë duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit si mjeti i fundit në dispozicion për kërkuesin. Dënimi i caktuar pa ligj i ka mohuar kërkuesit përfitimin e të drejtave njësoj si të dënuarit e tjerë të mitur, si edhe të drejtën e shuarjes së dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka zgjatur pasojat e paligjshmërisë dhe ka mohuar të drejtat e kërkuesit.

31. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka parashtruar prapësime në lidhje me bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuesit, por ka mbajtur qëndrimin se ato duhet të shqyrtohen gjatë procesit të rishikimit të vendimit penal të dënimit.

32. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj, e sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës dhe në nenin 7 të KEDNJ-së, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar. Çdo veprë penale duhet të parashikohet me ligj dhe individit duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë përmbajtjen e normës penale dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të saj, se çfarë veprimesh ose mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm (*shih vendimet nr. 32, datë 30.5.2023; nr. 16, datë 15.6.2009; nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Parimi që vetëm ligji mund ta përcaktojë krimin dhe të parashikojë masën e dënimit, nënkupton që veprat penale dhe masat e dënimit për ndëshkimin e tyre duhet të jenë të përkufizuara qartësisht me ligj. Nocioni “ligj” nënkupton disa kushte cilësore, sidomos ato të mundësisë së qasjes dhe të parashikueshmërisë. Këto kushte cilësore duhet të përmbushen si për përkufizimin e një vepre penale, ashtu edhe për masën e dënimit që ajo nënkupton ose për shtrirjen e saj (*shih vendimin nr. 32, datë 30.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata konstaton se, sipas akteve të dosjes së procesit penal të themelit, përfshirë edhe vendimin gjyqësor përfundimtar, kërkuesi rezulton të jetë i datëlindjes 29.9.1982 dhe në kohën e kryerjes së veprës penale, më datë 24.7.2000, nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç. Sipas nenit 51 të KP-së në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes përcaktohej se “për të miturit që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer.”. Gjatë procesit gjyqësor të themelit të zhvilluar në vitin 2001 në mungesë të kërkuesit, pavarësisht se ai është përfaqësuar me avokat, as ky i fundit, as prokurori nuk ka evidentuar faktin e të qenit të mitur të kërkuesit në kohën e kryerjes së veprës penale, për rrjedhojë nuk i kanë kërkuar gjykatës aplikimin e nenit 51 të KP-së në kuadër të caktimit të dënimit

penal ndaj tij. Po kështu, as gjykata e shkallës së parë nuk duket të ketë verifikuar moshën e kërkuarit në kohën e kryerjes së veprës penale, duke mos u shprehur as nëse në rastin konkret kishte vend për zbatimin e kësaj dispozite. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në vendimin e saj nr. 319, datë 25.10.2001, ka arsyetuar se “(...) dënimi i kërkuarit në masën e kërkuar nga prokurori për veprat penale për të cilat ai akuzohet, si dhe dënimi përfundimisht me 25 vjet burg, do t’ia arrijë qëllimit të edukimit të tij dhe të personave të tjerë të lënduar me frymën e zbatimit të ligjit.”. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankumuar as nga mbrojtësi i kërkuarit, ndërkohë që në vitin 2016, pra rreth 15 vjet më pas, kërkuari është ekstraduar nga shteti grek për qëllim të ekzekutimit të vendimit penal që e ka dënuar atë me 25 vjet burgim.

35. Pas ekstradimit kërkuari ka filluar procedurat për kundërshtimin e vendimit nr. 319/2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke pasur si qëllim, në thelb, aplikimin e nenit 51 të KP-së. Kundërshtimi i këtij vendimi është kërkuar nga kërkuari nëpërmjet vënies në lëvizje të 4 proceseve gjyqësore, një prej të cilave (ai me objekt “Shuarje dënimi”) ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, ndërsa një tjetër (ai me objekt “Rishikim vendimi”) ndodhet për shqyrtim në gjykatën e apelit.

36. Për sa i përket çështjes objekt ankimi kushtetues individual në Gjykatë, ajo me objekt “Ndreqjen e gabimit material”, konstatohet se gjatë shqyrtimit në gjykatën e shkallës së parë nga ana e mbrojtësit të kërkuarit është kërkuar bashkimi i kësaj çështjeje me atë me objekt “Shuarje dënimi”, meqenëse ndodheshin në të njëjtën fazë dhe kishin lidhje me njëra-tjetrën. Gjykata ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë, pasi nuk plotësoheshin kriteret e nenit 92 të KPP-së. Në përfundim, ajo ka vendosur edhe rrëzimin e kërkesës për korrigjimin e gabimit material me arsyetimin se baza ligjore nuk është e saktë, pasi mosaplikimi i nenit 51 të KP-së nuk ka të bëjë me gabim material në kuptim të nenit 114 të KPP-së, por me zgjidhjen e çështjes në themel.

37. Në vijim, mbi bazën e ankimit të kërkuarit, gjykata e apelit, me vendimin nr. 138, datë 20.7.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe aplikimin e nenit 51 të KP-së, me arsyetimin se kjo gjykatë ka zbatuar dhe interpretuar gabim ligjin, pasi aplikimi i nenit 51 të KP-së është detyrim dhe jo e drejtë e gjykatave, çka nuk ishte përmbushur në rastin e dënimit të kërkuarit, duke qenë kështu para rastit të një gabimi material të dukshëm që duhet të korrigjohet përmes urdhërimit për aplikimin e kësaj dispozite penale. Mbi bazën e rekursit të prokurorit, pasi e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar mbi kuptimin e institutit të “gabimit material” dhe duke u shprehur se ometimi i aplikimit të nenit 51 të KP-së pa asnjë ekuivok përbën një dënim të paligjshëm, por se paligjshmërisë së një dënimi të tillë nuk mund t’i jepet zgjidhje në kuptimin e korrigjimit të saj nëpërmjet procedurës së ndreqjes së gabimeve materiale, por vetëm nëpërmjet goditjes së vendimit të dënimit në rrugën normale të ankimit në të gjitha shkallët e gjyqësorit, pa përjashtuar edhe formën e jashtëzakonshme të ankimit, atë të rishikimit të vendimit (shih paragrafin 27 të vendimit nr. 00-2023-739(45), datë 8.2.2023 të Kolegjit Penal).

38. Ndërkohë, rezulton, gjithashtu, që kërkuari t’u jetë drejtuar gjykatave të zakonshme, në dy raste, edhe me kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të dënimit të dhënë në mungesë të tij. Në rastin e parë (procesi i dytë gjyqësor), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 427, datë 8.3.2018, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë. Mbi bazën e ankimit të kërkuarit, ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila e ka kthyer çështjen për rigjykim, në të cilin, me vendimin nr. 21, datë 14.1.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur përsëri mospranimin e kërkesës për rishikim, vendim i cili në vijim është lënë në fuqi me vendimin nr. 224, datë 11.4.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Ndaj këtij vendimi kërkuari ka vlerësuar të mos ushtrojë rekurs, për shkak se më parë, me vendimin nr. 138, datë 20.7.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë, atij i është pranuar kërkesa për ndreqjen e gabimit material në vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 319/2001, duke u urdhëruar aplikimi i nenit 51 të KP-së dhe përgjysmimi i dënimit të caktuar me këtë vendim. Edhe për sa i përket rastit të dytë (procesi i katërt gjyqësor), rezulton se Gjykata

e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me vendimin nr. 62-2023-2586(781), datë 26.6.2023, ka vendosur përsëri mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë, ndërkohë që me vendimin e saj të datës 8.2.2024 është pranuar kërkesa e kërkuarit për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të njoftimit të këtij vendimi, urdhërimin e sekretarisë për të kryer korrigjimet e nevojshme dhe regjistrimin e ankimit ose, në alternativë, rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër tij.

39. Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Sipas Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në të drejtën penale kërkesat e sigurisë juridike nuk janë absolute. Konsiderata të tilla si shfaqja e fakteve të reja ose zbulimi i një defekti thelbësor në procedurat e mëparshme që mund të ndikonte në rezultatin e çështjes, shkojnë të gjitha në favor të rihapjes së procedurave. Prandaj, ajo është shprehur se thjesht mundësia e rihapjes së një çështjeje penale është *prima facie* në përputhje me KEDNJ-në. Megjithatë, rrethana të veçanta të çështjes mund të tregojnë se mënyra në të cilën është përdorur ajo ka dëmton thelbin e një gjykimi të drejtë. Në veçanti, Gjykata duhet të vlerësojë nëse, në një çështje të caktuar, fillimi dhe kryerja e rishikimit janë ushtruar në atë mënyrë që të arrihet, sa më shumë e mundur, një ekuilibër i drejtë midis interesave të individit dhe nevojave për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale (*shih Nikitin kundër Rusisë, nr. 50178/99, §§ 55-57, ECHR 2004 VIII*).

41. Po sipas GJEDNJ-së, kompetenca e gjykatave më të larta për rishikimin e vendimeve duhet të ushtrohet vetëm për të korrigjuar gabimet gjyqësore dhe gabimet e drejtësisë, dhe jo për të kryer një shqyrtim të ri. Rishikimi nuk duhet të trajtohet si një apel “i maskuar” dhe thjesht mundësia që të ketë dy pikëpamje për të njëjtën çështje nuk është një bazë për rigjykim. Një shmangie nga ky parim justifikohet vetëm kur është e nevojshme nga rrethana të një karakteri thelbësor dhe imponues (*shih Bujnița kundër Moldavisë, nr. 36492/02, datë 16 janar 2007, §20; Bota kundër Rumanisë, nr. 16382/03, datë 4 nëntor 2008, §§ 33 dhe 34*). Një dënim që shpërfill provat kryesore përbën një dështim të drejtësisë penale dhe lënia e gabimeve të tilla të pakorrigjuara mund të ndikojë seriozisht në drejtësinë, integritetin dhe reputacionin publik të procedurave gjyqësore (*shih Lenskaya kundër Rusisë, nr. 28730/03, §§ 39 dhe 40, 29 janar 2009; Giuran kundër Rumanisë, nr.24360/04, § 39, GJEDNJ 2011 (ekstrakte)*). Në mënyrë të ngjashme, lënia në fuqi, pas procedurave të rishikimit, e një dënimi që shkel të drejtën për një gjykim të drejtë përbën një gabim vlerësimi që e përjetëson atë shkelje (*shih Yaremenko kundër Ukrainës (nr. 2), nr. 66338 /09, datë 30 prill 2015, §§ 52-56 dhe 64-67*).

42. Duke iu referuar rrethanave të kësaj çështjeje, Gjykata vëren se me vendim gjyqësor kërkuarit i ishte njohur e drejta që në vendimin penal të dënimit me 25 vjet burgim të aplikohet ulja e dënimit sipas nenit 51 të KP-së, për shkak të moshës së mitur në kohën e kryerjes së veprës penale. Me marrjen formë të prerë, për efekt të ekzekutueshmërisë së këtij vendimi, kërkuari ka hequr dorë nga çdo mjet tjetër ankimi që kishte përdorur pavarësisht qëllimit për të cilin ushtrohen ato dhe rezultatit që mund të sillnin në të drejtën e cenuar. Po kështu, ajo vëren se Gjykata e Lartë, në kohën që ka shqyrtuar rekursin e prokurorit ndaj vendimit të gjykatës së apelit që kishte pranuar kërkesën e kërkuarit për ndreqjen e gabimit, ka qenë në dijeni edhe të ecursisë së proceseve të tjera gjyqësore.

43. Gjykata e Lartë, në rastin konkret, duke iu referuar procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga kërkuari, si dhe shkaqeve e bazës ligjore mbi të cilën ai ka bazuar kërkesën për korrigjimin e gabimit

material në vendimin penal të formës së prerë nr. 319/2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk ka pasur hapësirë për të përcaktuar shkaqet e rishikimit ose të korrigjimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, ndërkohë që ajo ka detyrimin të veprojë në përputhje me të drejtën procedurale dhe materiale penale të zbatueshme në çështjen mbi të cilën vihet në lëvizje. Në rastin konkret, pavarësisht shkakut të rekursit, në arsyetimin e vendimit të saj Gjykata e Lartë, ndonëse nuk e ka vënë në dyshim situatën faktike të pranuar nga gjykata e apelit dhe konkluzionin e saj për paligjshmërinë e dënimit, e ka lënë të nënkuptuar ekzistencën e një gabimi të dukshëm në zbatimin e ligjit në vendimin që e ka dënuar kërkuesin, për shkak të moszbatimit të nenit 51 të KP-së. Nisur nga fakti që kjo situatë ende nuk është riparuar nga gjykatat, pavarësisht mjeteve të përdorura nga kërkuesi, (i cili aktualisht është duke vuajtur një dënim dyfish më të lartë se sa ai që duhet të ishte duke vuajtur), Gjykata e Lartë me qëndrimin e saj nuk e ka përjashtuar mundësinë e përdorimit të një mjeti juridik në dispozicion të kërkuesit për korrigjimin e gabimeve të kryera nga gjykatat e zakonshme në procesin e themelit, atij të rishikimit të vendimit, sikundër as mundësinë e efektivitetit të këtij mjeti.

44. Gjykata vlerëson të theksojë se ai gabim i mundshëm, i pohuar pozitivisht ose i nënkuptuar nga gjykatat e zakonshme në zbatimin e ligjit penal në procesin e themelit ndaj kërkuesit, është i asaj natyre që vë në diskutim pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe KEDNJ-në të vendimit penal të dënimit të tij. Megjithatë, nuk i takon kësaj Gjykate të ripërcaktojë faktet e çështjes ose mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme. Referuar fakteve të çështjes konkrete në shqyrtim, edhe pse procedurat gjyqësore të procesit të themelit që kanë deklaruar fajtor dhe kanë dënuar kërkuesin potencialisht, duken arbitrare për sa kohë bëhet fjalë për lejimin e gabimeve të dukshme nga pikëpamja e ligjit të tilla që çojnë në “mohim të drejtësisë”, Gjykata nuk vë në dyshim vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë në drejtim të mënyrës se si ajo ka interpretuar nenin 114 të KPP-së në rastin konkret. Gjithsesi, ajo gjykatë, duke pasur në vëmendje se vendimi i saj e zhvishte kërkuesin nga e drejta për të pasur një korrigjim të vendimit penal të dhënë ndaj tij nëpërmjet mjetit të zgjedhur nga ai në atë rast, ka identifikuar pasjen e një mundësie tjetër për kërkuesin për të kërkuar rihapjen e procesit ose rishikimin e vendimit penal të dhënë ndaj tij. Referuar këtij mjeti të rekomanduar nga Gjykata e Lartë, kërkuesi ka vënë në lëvizje procesin (*e katërt*) përmes të cilit ka kërkuar rishikimin e vendimit të formës së prerë të dënimit të tij, ndaj Gjykata çmon të theksojë se në këtë proces gjykatat e zakonshme dhe prokuroria duhet të tregojnë kujdesin e duhur me qëllim mundësimin e riparimit të shkeljes potenciale të të drejtave kushtetuese të kërkuesit, pikërisht në lidhje me respektimin e parimit të mosdënimit pa ligj, riparim ky i kërkuar nga kërkuesi, tashmë prej 8 vjetësh, për të cilin ai ende nuk ka një përgjigje përfundimtare nga sistemi gjyqësor. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimet nr. 56, datë 9.11.2023; nr. 6 datë 22.2.2022; nr. 5, datë 2.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj në procesin e kundërshtuar të përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-739(45), datë 8.2.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 7.3.2024.

Shpallur, më 8.4.2024.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska,
Marjana Semini